 3. Ministri i Arsimit dhe i Shkencës miraton rregulloren e funksionimit të QTKA-së.
 4. Drejtuesit e QTKA-së (drejtori dhe kancelari) emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave "Për emërimin, lirin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit".
 5. Nëpunësit e QTKA-së (përgjegjës sektori, specialistë) emërohen pas një procesi konkurrues, në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".
 6. Pagat e drejtuesve dhe të nëpunësve të QTKA-së caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
 7. Numri i punonjësve të QTKA-së të jetë brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve të sistemit të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.
 8. Për punonjësit, që, pas riorganizimit, rezultojnë pa vende pune, të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.
 9. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.657, datë 25.9.2003

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.321, DATË 5.7.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË FONDEVE SIPAS RRETHEVE, PROCEDURAT E MIRATIMIT TË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË DHE KUSHTET E

DHËNIES SË KREDISË NË KUADRI E KREDISË GREKE PËR STREHIM”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8448, datë 25.1.1999 “Për ratifikimin e kredisë greke për programin e strehimit”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.321, datë 5.7.1999 të Këshillit të Ministrave, pas pikës 7/1 shtohen pikat 7/2, 7/3, 7/4 dhe 7/5, me këtë përmbajtje:

“7/2. Deri në livrimin e kredisë greke për programin e strehimit, rastet më emergjente të evidentuara sipas pikës 1/b të vendimit, të trajtohen me fondet e Buxhetit të Shtetit, të cilat i jepen Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, në zërin “Investime për ndërtim dhe blerje banesash për familjet, që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale”. Këto fonde të menaxhohen nga Enti Kombëtar i Banesave, me kushte të njëjta me ato të përcaktuara në pikën 2 të vendimit nr.191, datë 21.6.1994 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të apartamenteve, që ndërtohen me fonde shtetërore”, i ndryshuar. Të ardhurat, që Enti Kombëtar i Banesave mbledh nga shitja e banesave, të derdhen në Buxhetin e Shtetit.

7/3. Trajtohen me përparësi familjet e evidentuara deri më datë 30.8.1999 sipas pikës 5 të vendimit nr.321, datë 5.7.1999 të Këshillit të Ministrave, të cilat banojnë në apartamente të marra me qira dhe plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- banojnë në mjedise që nuk janë fond banese ose në banesa me kushte të vështira higjieno-shëndetësore;

- kanë të ardhura të pamjaftueshme për të përballuar qiranë e banesës;
- kanë në përbërje të tyre një të sëmurë me raport të përhershëm mjekësor;
- janë njëprindërorë dhe kanë në ngarkim fëmijë.

Për të verifikuar rastet më emergjente të përdoren treguesit e mëposhtëm:

- sipërfaqja faktike e shfrytëzimit për frymë të mos jetë më shumë se 6 m² për person;
- pagesa mujore për qiranë të mos jetë më pak se 30 për qind e të ardhurave mujore;
- certifikata e gjendjes familjare, në rastet e shkurorëzimit, duhet të jetë e datuar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Këto të dhëna t’i dërgohen Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, sipas tabelës që i bashkëlidhet, për efekt llogaritjeje dhe planifikimi. Verifikimi të kryhet brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

7/4. Dokumentacioni, që duhet të dorëzojë familja pranë organeve të qeverisjes vendore për të përfituar kredi, është si më poshtë vijon:

- vërtetimi i tre muajve të fundit nga zyra e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme që, në emër të kryefamiljarit dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes, nuk rezulton të jenë regjistruar prona të paluajtshme në pronësi ose të lëna në barrë hipotekore;

- vërtetimi i tre muajve të fundit nga zyra e taksave që kryefamiljari ose pjesëtarë të familjes nuk janë subjekt i TVSH-së;

- vërtetim nga Komisioni i Kthimit dhe i Kompensimit të Pronave që, në emër të kryefamiljarit ose pjesëtarëve të tjerë të familjes, nuk u është kthyer ose kompensuar prona.

7/5. Për familjet e evidentuara, sipas pikës 1/b dhe që përfitojnë kredi, organet e qeverisjes vendore dhe Enti Kombëtar i Banesave, përveç verifikimit të dokumentacionit, të kryejnë dhe verifikimin në banesën ku familja jeton me qira.”.

2. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, Ministria e Financave, organet e qeverisjes vendore dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Fatos Nano**

VENDIM
Nr.658, datë 25.9.2003

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.518, DATË 12.8.1996 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KATEGORIZIMIN, KLASIFIKIMIN DHE
REGJISTRIMIN E NJËSIVE AKOMODUESE”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 3 të vendimit nr.518, datë 12.8.1996 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, në guidën e kategorizimit dhe të klasifikimit të njësive akomoduese turistike, të bëhet ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

1. Kapitulli III "Kriteret e kategorizimit dhe të vlerësimit të fshatrave turistike" ndryshohet dhe zëvendësohet me kapitullin III, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pas kapitullit III shtohet kapitulli IV “Kriteret e vlerësimit dhe të klasifikimit me yje të kampingjeve”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

III. KRITERET E VLERËSIMIT DHE TË KLASIFIKIMIT ME YJE TË FSHATRAVE TURISTIKE

Fshatrat turistike – janë struktura akomoduese komplekse, me vendndodhje kryesisht në zona ose pika turistike, të cilat, brenda një perimetri unik të kufizuar, ofrojnë për klientelën vendase dhe të huaj gamën më të plotë të shërbimeve akomoduese turistike, shërbimet e veprimtarive sportive, argëtuese dhe çlodhëse.

Fshatrat turistike janë:

- a) me vila,
- b) me bungalou.

Vilat - janë struktura akomoduese me arkitekturë të veçantë, në përshtatje me vendndodhjen, jo më shumë se tre kate, të përbëra prej apartamentesh, me hyrje të pavarura, të ndara ose brenda së njëjtës strukture, me mobilim dhe dekorim standard dhe me të gjitha pajisjet e nevojshme.

Bungalou - janë struktura akomoduese, të ndëtuara si rregull nga druri ose materiale të tjera të ngjashme dhe me kapacitete akomoduese të përshtatshme për jo më shumë se katër persona.

Elemente të përgjithshme për vlerësim dhe klasifikim

A. Elemente të jashtme:

1. Pamja e jashtme, zgjidhja konceptuale arkitektonike, origjinaliteti dhe përshtatshmëria e strukturës akomoduese me vendndodhjen.

2. Respektimi i normativave dhe raporteve urbanistike përpjesëtimore të zënies dhe shfrytëzimit të sipërfaqes së përgjithshme të fshatit:

- sipërfaqe ndërtimore e strukturës akomoduese40-60% (sipas nivelit klasifikues, zgjidhjes arkitektonike, vendndodhjes);

- sipërfaqe e gjelbëruar 20-30% (në varësi të nivelit klasifikues);

- sipërfaqe për terrene sportive dhe mjedise argëtuese 20-30%.

3. Zgjidhja konceptuale e tarracave, trotuareve, shesheve të hapura, terreneve sportive dhe

argëtuese për të rritur dhe fëmijë, mjediseve çlodhëse dhe lulishteve në përshtatshmëri me vendndodhjen e fshatit dhe karakteristikat specifike të zonës.

4. Materialet e përdorura për veshjen e jashtme të strukturës akomoduese sipas vendndodhjes dhe karakteristikave të zonës.

5. Elementet dekorative.

6. Tabelë orientuese, planimetria e fshatit në hyrje, hyrje e sistemuar, pengesë dhe tra i vendosur përpara hyrjes kryesore.

7. Rrethimi i fshatit, kabinë për rojën, rojë 24 orë.

8. Parking brenda perimetrit të fshatit, në afërsi me zonën e hyrjes.

B. Elemente të brendshme:

- recepsion i pozicionuar përballë hyrjes kryesore,
- ofron të gjitha informacionet e nevojshme,
- kasafortë për ruajtjen e sendeve me vlerë,
- telefon në dispozicion të klientëve,
- buton emergjence i lidhur me dhomat pa telefon,
- këmbim valute,
- kënd pritjeje,
- qendër zëri e lidhur me altoparlantë me mjediset e hapura,
- sistem alarmi i shpërndarë në mjediset e ndryshme dhe i lidhur direkt me informacionin,
- radio për çdo dhomë,
- çelës rezervë për çdo hyrje,
- vend i veçantë për të varur çelësin (pas derës së dhomës),
- restorant,
- tualete të përbashkëta,
- ambiente të veçanta për personelin,
- repart mirëmbajtjeje dhe personel në gatishmëri,
- njësi shitjeje për artikuj të ndryshëm ose treg për pazare,
- vende për tharjen e rrobave,
- sistem sinjalizimi ose komunikimi për vizitorët e jashtëm,
- personel drejtues në dispozicion,
- pajisjet e ndihmës së shpejtë, ofrim në çdo kohë i shërbimit mjekësor emergjent,
- farmaci e vogël.

Restoranti:

- zgjidhje arkitektonike në harmoni me karakteristikat e strukturës,
- restorant i hapur me vende ulje min. 50% e numrit të shtretërve, i mbrojtur nga agjentët atmosferikë,
- restorant i mbyllur me kapacitet 20% të numrit të shtretërve.

Kuzhina:

- pajisje bashkëkohore,
- nivel i lartë higjiene,
- sistem ventilimi,
- pajisje frigoriferike në vartësi me kapacitetin e restorantit,
- dizinfektim periodik për mbrojtjen nga insektet dhe parazitët, të kryera nga organet kompetente, të evidentuara me procesverbal.

Magazini:

- ruajtja e artikujve në kushte normale sipas natyrës, kërkesave higjieno-sanitare dhe standardeve,
- magazinimi i veçantë për artikujt ushqimorë dhe industrialë.

Lavanteri ose shërbim lavanterie nga jashtë:

Shërbimi i pastrimit në mjediset e brendshme:

- pastrim dhe dezinfektim çdo ditë nga personeli i shërbimit i nyjeve sanitare,
- solucione pastrimi dhe detergjentë të ndryshëm, në rast mospastrimi periodik të dhomave prej personelit të shërbimit,
- në rast pastrimi nga klientët, kontroll nga personeli i shërbimit për nivelin e pastërtisë në dhoma, ndërrimin e biankerive, trajtimin e mbeturinave etj.

Masat mbrojtëse kundër zjarrit dhe shpëtimin:

- zbatim i udhëzimeve dhe rregullave të organit kompetent,
- masat parandaluese kundër zjarrit dhe shpëtimin, daljet emergjente në përpjesëtim me numrin e dhomave,
- pajisje zjarrfikëse të standardeve ndërkombëtare në gatishmëri,
- sistem alarmi në intervale çdo 50 ml,
- udhëzimet përkatëse në rastet e emergjencës në të gjitha dhomat dhe mjediset e përbashkëta të paktën në dy gjuhë të huaja,
- materiale dhe pajisje me rezistencë të lartë kundër zjarrit.

Banjat e dhomave dhe ambientet e përbashkëta duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat e banjave të hoteleve sipas kategorive respektive.

Zona e plazhit (për fshatra bregdetare dhe liqenore):

- e sistemuar, nivel i lartë pastërtie dhe higjienë,
- çadra dielli, shezlong, kosha për hedhjen e mbeturinave,
- tualete për burra e gra, dushe,
- grup shpëtimi.

Fshatra turistike me “1 yll”

a) me bungalou:

- min. 15 njësi,
- sip. min. për dy persona 28 m²,
- min. 3 m² shtesë për person, jo më shumë se katër persona.

Në bungalou nuk lejohet gatimi.

b) me vila:

- kapaciteti min. 20 apartamente,
- sip. min. për dy persona 35 m²,
- min. 8m² shtesë për person, por jo më shumë se katër persona.

Në njësi me dy dhoma gjumi, detyrimisht duhet të ketë dy dushe.

- hyrje të pavarura,

- rrugëkalimet që lidhin vilat ose bungatotë me njëra-tjetrën të niveluara, të sistemuara dhe të shtruara,

- ventilator,
- rrjeta teli për parandalimin e insekteve,
- sallon me kënd ndenje,
- ballkon ose verandë të kompletuar, në përshtatje me vendndodhjen,
- telefon në dhomë i lidhur me recepsionin,
- kënde sportive për futboll, volejball, basketboll, tenis, etj.,
- lojëra uji, ekskursione të ndryshme dhe koncerte variëte,

Vendi i gatimit, kuzhina:

- e izoluar nga dhomat e gjumit, sistem ventilimi,
- lavaman, ujë i rrjedhshëm i nxehtë dhe i ftohtë,
- sobë gatimi, frigorifer, bufe për enë guzhine dhe ushqime,
- tavolinë buke me karrige,
- pajisje për gatim, pjata, pozateri etj.,
- kosha të mbuluar për mbeturinat (material jo i djegshëm),
- nuk lejohet dera e banjës në ambientin e gatimit.

Lejohet pastrimi i ambienteve të brendshme nga vetë pushuesit.

Fshatrat turistike me “2 yje”

Duhet të plotësojë të gjitha kriteret e fshatrave turistike me 1 yll, plus:

a) me bungalou:

- min. 20 njësi,
- sip. min. 32m²,

b) me vila:

- minimumi 30 apartamente,
- sip. min. 40m²,
- ndërimi i biankerive një herë në tre ditë,

- televizor, telefon në çdo dhomë,
- ajër të kondicionuar,
- bagazhist,
- rrugëkalimet të shtruara me asfalt ose pllaka jo të rrëshqitshme,
- shkallët e vilave të shtruara me pllaka cilësore,
- pastrim i detyruar i apartamenteve dhe ambienteve të brendshme me personel shërbimi,
- sallë ose ambient të mbuluar për lojëra të qeta (domino, letra, tavëll),
- varka për strukturat bregdetare,
- ambiente të hapura për të dëgjuar muzikë,
- bilardo.

Fshatrat turistike me “3 yje”

Përveç kërkesave të fshatrave turistike me 2 yje, duhet të plotësojnë:

a) me bungalou:

- min. 35 njësi,
- sip. min 35 m²,

b) me vila:

- min. 40 apartamente,
- me sip. min. 45 m²,
- ndërrimi i biankerive çdo dy ditë,
- makina larëse automatike për përdorim nga klientët,
- termometër i dallueshëm në një vend të dukshëm në hyrje të fshatit,
- shërbim mëngjesi në dhomë sipas kërkesës së klientëve,
- parking i mbyllur (garazh) për 20% të numrit të apartamenteve,
- afishimin e programeve kulturore brenda zonës së fshatit,
- pikë shitje biletash për aktivitete kulturore jashtë fshatit,
- transport i brendshëm,
- saune-solarium, pishinë e hapur për të rritur dhe fëmijë,
- palestër,
- sallë leximi, zyrë informative, internet.

Fshatrat turistike me “4 yje”

a) me bungalou:

- kapaciteti min. 40 njësi,
- sip. min. 40 m²,

b) me vila:

- kapaciteti min. 50 apartamente,
- sip. min. 55m²,
- struktura akomoduese, jo më shumë se tre kate,
- parking në hyrje të fshatit, për min.5 autobuzë,
- ndërrimi i biankerive çdo ditë,
- sipërfaqe ose shesh i gjelbëruar min.30% e sipërfaqes totale,
- shkallët, koridoret dhe ambientet të shtruara me moket cilësor,
- çelësa me kod,
- shërbim në dhomë,
- min. dy zyra për administratën,
- dhomat e gjumit shumë komode,
- pajisjet me materiale shumë cilësore,
- shërbim telefonik në dhomë,
- shërbim me staf të specializuar, organizuar në kate dhe nivel të lartë,
- të gjitha ballkonet dhe dritaret me tenda dielli,
- restorante me gatim cilësor dhe larmi asortimentesh, kapaciteti i vendeve të uljes 70 % e numrit të shtretërve, tavolina dhe karrige për fëmijë ose sallë e veçantë për fëmijë,
- sallë restoranti ose salet për klientelën vip,
- bar-kafe e mbuluar në 30 % të sipërfaqes,
- pajisje kuzhine për gatim, servise për ngrënie, çaj, kafe, pije etj. shumë cilësore, mundësisht me emblema,

- pishinë e hapur dhe e mbyllur për të rritur dhe fëmijë,
- mjedise dhe këndet e lodrave për fëmijë me tualete të veçanta,
- tualet komune për burra dhe gra,
- hyrje dhe tualete për antikap,
- njësi tregtimi, non stop,
- shërbim lavanterie brenda territorit të fshatit,
- tarraca të hapura me vende ulje me kapac. min. 20 % të shtretërve ,
- pajisje automatike për pastrimin e këpucëve,
- kutinë e ndihmës së shpejtë në çdo apartament,
- depo për bagazhet,
- depo për pajisjet e sportit ose materiale të tjera të pushuesve,
- frigorifer portativ,
- dhomë mjeku min. 20 m²,
- mjek dhe infermiere në shërbim non stop,
- pastrim kimik,
- parukeri për burra dhe gra,
- kopësht ditor për fëmijë,
- kosha për fëmijë sipas kërkesës,
- parking të mbyllur për min. 20 % të kapacitetit të apartamenteve,
- teatër veror,
- pistë vallëzimi,
- diskotekë,
- minimumi katër lloje të ndryshme sporti të një cilësie të lartë si:
vegla gjimnastikore, sallë bilardoje, fusha basketbolli, golf, tenis,
- fitnes,
- kurse të ndryshme për sport, pikturë, gjuhë të huaja, kompjuter etj.,
- zona e plazhit me pajisje të nivelit të lartë.

Sistemi i ngrohjes qendrore nuk është i detyruar për fshatrat sezonalë.

Niveli i komfortit, dekorimi i dhomave, mjediseve dhe shërbimet e tjera plotësuese, sipas vendndodhjes dhe kohëzgjatjes së veprimtarisë.

IV. KRITERET E VLERËSIMIT DHE TË KLASIFIKIMIT ME YJE TË KAMPINGJEVE

Kampingjet - janë struktura akomoduese turistike me karakter sezonal, të ndërtuara në hyrje të qyteteve, në afërsi të rrugëve kryesore, afër detit, liqenit, në vende malore dhe pranë peizazheve të virgjëra natyrore.

Garantojnë qëndrim dhe trajtim të personave për pushime në çadra, rulo e të tjera objekte të ngjashme. Ato duhet të ofrojnë hapësirën e mjaftueshme brenda një territori të caktuar, rregullat e pajisjet e përshtatshme për kamping, si dhe të sigurojnë qëndrimin e turistëve të ardhur me mjetet e transportit personal ose në një formë tjetër.

Moto e kampingjeve: organizimi dhe menaxhimi i kohës së lirë.

Kërkesat minimale:

- i ndërtuar në një mjedis me parametra normalë, sipërfaqe e sheshtë, në mjedise të gjelbëruara, të pyllëzuara, në toka pa lagështirë dhe mjegull,
- larg nga objektet industriale që prishin ajrin dhe qetësinë,
- terren i mbrojtur, për zonat e prekura nga erërat këshillohen pengesa,
- i lidhur me rrugë automobilistike me qendrat e banuara,
- rruga për në kamping e asfaltuar ose e shtruar mirë, me dy kalime min. 5.5-6 m dhe detyrimisht e lidhur me rrugën kryesore,
- i gjithë perimetri i kampit i rrethuar me mure, kangjella ose rrethim i gjelbër i pa kalueshëm,
- i siguruar me rojë 24 orë,
- pengesa dhe tra sigurie për parandalimin e automjeteve,
- kanalizimi i ujërave sipas kushteve teknike,
- mjedisi brenda dhe jashtë kampit i sistemuar, i gjelbëruar dhe me lulishte,
- lista e çmimeve për kamping dhe e shërbimeve që ofrohen,
- për klientë të jashtëm në hyrje të kampit, në një vend të dukshëm, vendoset tabelë e veçantë me listën e shërbimeve për fjetje, ushqim dhe argëtim me çmimet respektive, në qoftë se ofron një

shërbim të tillë,

- termometër i lexueshëm në distancë,
- të afishuara në mjediset e kampit rregullat higjieno-sanitare të detyrueshme për t'u respektuar nga të gjithë,
- ambientet brenda kampit detyrimisht të ndriçuara,
- çdo ditë pastrimi dhe dezinfektimi i mjediseve sanitare,
- çdo njësi të ketë të vendosur numrin korrespondues, estetik dhe të dukshëm,
- parking me hyrje të veçantë,
- parking, ngjitur me kampin, jashtë perimetrit të tij, për min.3 autobusë,
- bazamente betoni për vendosjen e çadrave, distanca nga toka minimumi 40 cm,
- zyrë recepsioni,
- telefon ose kabinë telefoni në dispozicion të klientëve,
- zyrë për administratën,
- shërbim postar,
- ofrim i ndihmës së parë mjekësore,
- qendër zëri dhe autoparlantë në të gjitha ambientet,
- ambientet e akomodimit të ventiluara, min. ventilator,
- restorant,
- kafeteri,
- mjedise sportive,
- mjedise argëtuese,
- kënde lodrash për fëmijë,
- tualete të ndara për burra e gra në kushte të larta higjieni, me ajrosje natyrale ose artificiale, ndriçim i mjaftueshëm, lavaman me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë, sapun i lëngshëm, letër higjienike, tharëse për duar, kosha për hedhjen e mbeturinave,
- tualetet në distancë me sistem alarmi për arsye sigurie,
- tualete për fëmijë,
- hapësirë e mbuluar që garanton kushte për gatim, ngrënie dhe larjen e enëve,
- vend për larjen dhe tharjen e rrobave i rrethuar me gjelbërim,
- pajisje frigoriferike për 50 % të numrit të kampistëve,
- grupet e shpëtimit dhe ofrimi i ndihmës së shpejtë (për strukturat bregdetare),
- ujë i nxehtë dhe i ftohtë 24 orë,
- për rastet problematike, autobote me ujë në parametra normale,
- ujë në parametra normale, min. 80 lit. për person në ditë,
- ujë jo i pijshëm min. 50 lit. për person në ditë,
- rezervuar uji min. për dy ditë 50 lit. për person,
- energji elektrike pa ndërprerje e siguruar nga rrjeti ose me gjenerator pa zhurmë,
- personel për shërbim elektrik në gatishmëri 24 orë,
- personel shërbimi për mirëmbajtjen,
- fasilitetet për pastrimin e mjediseve të brendshme,
- njësi tregtimi për artikuj të domosdoshëm, si parfumeri, materiale fotografike, gazeta etj.,
- njësi për artikuj ushqimorë dhe fruta-perime, kur distanca e kampit nga zonat e banuara është më shumë se 800 ml,

- ekonomi ndihmëse, nëse është e mundur,
- ambiente për ruajtjen e biankerive,
- sigurimi dhe funksionimi i pajisjeve të MKZ në të gjitha mjediset e brendshme dhe të jashtme, afishimi i masave mbrojtëse në gjuhën shqipe dhe të paktën në një gjuhë të huaj,
- antena televizive.

Kampingjet me "1 yll"

- kapacitet min.30 njësi,
- kapacitet maksimumi për çdo njësi akomodimi 4 persona,
- sipërfaqja min. e territorit në dispozicion të çdo njësie 60 m²,
- sipërfaqja e lirë për shëtitje 10% e sip. totale,
- lulishte jo më pak se 10 % e sipërfaqes totale,
- nyje sanitare të rregullta të mbuluara për 15 % të kampistëve,

- distanca e tualetit nga ambienti i akomodimit maks.150 ml,
- ambiente të mbuluara për gatim e larjen e enëve për min. 20 %të numrit të përgjithshëm të kapistëve,

- për kampingjet bregdetare dushe në natyrë ose vende të hapura me ujë të ftohtë dhe të nxehtë min. 1 dush për 50 persona,

- bar,
- lojëra shahu, tenis,
- shesh lodrash për të rritur dhe fëmijë,
- organizimin e programeve të ndryshme me grupe amatore,
- programe argëtuese për fëmijë,
- ture në këmbë për njohjen e zonës përreth kampingut,
- siguron transport individual,
- autoservis,
- ambient ose magazinë për ruajtjen e bagazheve për klientët me qëndrim afatshkurtër,
- infermieri.

Kampingjet me "2 yje"

Duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat e kampingjeve me dy yje plus:

- rruga për në kamping e asfaltuar,
- në hyrje të kampit reklamë e ndriçuar,
- për çdo njësi akomoduese sipërfaqja në dispozicion min. 80 m²,
- bazamentet e çadrave të shtruara me pllaka ose material i ngjashëm,
- këmbim valute,

- nyje sanitare (tualet) të ndara për burra e gra, të rregullta dhe të mbuluara për 20 % të kapistëve,

- ambient i gjelbërura ose lulishte 15 % e sipërfaqes së përgjithshme,
- kabina dushi me sip. min. 1.2 m² të mbyllura, për min. 20 % të kapistëve,
- tualete për fëmijë për 10 % të numrit të kapistëve, maksimumi. 50 cm lartësi nga dysHEMEJA,

- vend i veçantë për tharjen e rrobave i rrethuar me gjelbërim,
- një çezmë për 70 persona me ujë të rrjedhshëm në ambientet e përbashkëta,

- vend gatimi i mbuluar dhe i pajisur me banakë pune, si dhe pajisje të tjera të domosdoshme, për jo më shumë se 60 persona,

- vend për larjen e enëve për min. 60 persona i pajisur me lavamanë, ujë të nxehtë e të ftohtë në çdo kohë,

- një zgarë e madhe për përdorim të përbashkët,
- vend për larjen e makinave, i betonuar, sip. min. 8 m² me kanalizim të rregullt,
- sheshe të veçanta për fëmijë,
- instruktor noti,
- organizon kurse të ndryshme sipas interesit,
- siguron transport me taksì,
- rezervim bileta avioni e trageti,
- sipas kërkesave të klientëve siguron rezervim në njësi të tjera akomoduese.

Kampingjet me "3 yje"

Duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat e kampingjeve me dy yje plus:

- sipërfaqja në dispozicion të një njësie akomoduese 100 m²,
- largësia e tualeteve jo më shumë se 100 ml nga vendi i akomodimit,
- temperaturë normale në të gjitha ambientet,
- sheshet e gjelbëruara të zënë 30%të sipërfaqes,
- sigurimi i transportit të brendshëm,
- nyje sanitare të mbuluara për 30 % të kapistëve,
- kabina dushi për 30 % të kapistëve,
- tualete për fëmijë për 15 % të numrit të kapistëve,
- tualete për antikap,
- makina larëse automatike në dispozicion të kapistëve,

- për çdo 50 kampistë çezmë e përbashkët në ambientet e jashtme,
 - për çdo 45 kampistë një vend gatimi i mbuluar me banak, pajisje dhe enë për gatim,
 - ambient i rregullt me lavamanë cilësorë, ujë të nxehtë dhe të ftohtë për larjen e enëve për 40 % të kampistëve,
 - qendër tregtimi që ofron gamë të gjerë artikujsh si suvenire, artikuj ushqimorë, fruta e perime, artikuj kozmetikë, sportivë dhe të tjerë artikuj të domosdoshëm,
 - bar-kafe non-stop, pastičeri, bufe,
 - fusha për aktivitete sportive të ndryshme,
 - kabinë masazhi min. 5 m²,
 - një çadër dielli për çdo njësi akomodimi,
 - shezlong, në raport me kapacitetin e shtretërve,
 - biankeri për krevetet, peshqirë,
 - servis për kafe, çaj e të tjera,
 - radio-magnetofonë,
 - zyrë informacioni,
 - zgara për të pjekur,
 - pishinë e hapur, sallë për televizor, sallë leximi,
 - personel për pastrim të ambienteve të brendshme akomoduese,
 - biankeri cilësorë,
 - kopësht për fëmijë,
 - kasaforta për sendet me vlerë,
 - informacion për tarifën e transportit urban dhe privat,
 - informacion për aktivitetet kulturore, sportive, etj. brenda zonës së fshatit e jashtë saj, programet dhe oraret,
 - vend për ruajtjen e bagazheve,
 - garazh i mbyllur për 20 % të kapacitetit,
 - dhomë mjeku min. 20 m², minifarmaci,
- Në kampinjet me 3 yje lejohen brenda territorit të kampit bungalou, por jo më shumë se 20% e numrit të përgjithshëm të njësive. Në bungalou është i ndaluar kategorikisht gatimi.

VENDIM

Nr.659, datë 25.9.2003

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË PREKEN NGA NDËRTIMI I KANALIT TË UJËRAVE TË LARTA NË KOMUNËN KOTË, VLORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorimin të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme të pronarëve të cilët preken nga ndërtimi i kanalit të ujërave të larta në komunën Kotë, Vlorë.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të komunës Kotë, Vlorë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi për sipërfaqet 2183 m² tokë truall, 1750 m² tokë bujqësore, 3002 m² sipërfaqe jonxhë, 27 rrënjë drufrutorë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 2 991 740 (dy milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e dyzet) lekësh.
4. Fondi prej 2 991 740 (dy milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e dyzet) lekësh, për kompensimin e pronarëve të shpronësuar, të përballohet nga buxheti i vitit 2003, zëri "Investime" i miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale në shumën prej 223 000 (dyqind e njëzet e tre mijë)

- lekësh, të përballohet nga komuna Kotë, e cila do të kryejë edhe pagesën e pronarëve të shpronësuar.
6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë brenda peridhës 1-15 tetor 2003.
7. Punimet të përfundojnë brenda muajit dhjetor 2004.
8. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe komuna Kotë, Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E KANALIT TË
UJËRAVE TË LARTA NË KOMUNËN KOTË, VLORË

Nr	Emri Mbiemri	Sip/tokë bujqësore m ²	Çmim për m ²	Sip/toke truall m ²	Çmim për m ²	Dru frutorë	Çmim	Hardhi rrënjë	Çmim	Jonxhë sip m ²	Çmimi për m ²	Vlera në total (lekë)
1	Trashëgimtarët e Memisha Myrtaj											
	Neki Myrtaj Hariz Myrtaj Feti Myrtaj Tefide Myrtaj Emine Dapaj Gjergji Myrtaj Perlat Myrtaj Enver Myrtaj Jahja Myrtaj			1833	900	11	2000			1257	20	1 696 840
2	Enver Muhamed Myrtaj			350	900	11	2000	16	3000			385 000
3	Perlat Muhamet Myrtaj	525	500							525	20	273 000
4	Bilbil Shefit Likaj	350	500							350	20	182 000
5	Astrit Haxhi Memaj	875	500							870	20	454 900

Gjithsej

2 991 740

VENDIM
Nr.660, datë 25.9.2003

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË

**PREKEN NGA SISTEMIM-ASFALTIMI I RRUGËS NGA QENDRA E QYTETIT NË
DREJTIM TË VARREZAVE, SISTEMIM-ASFALTIMI I RRUGËS NDËRMJET DY
SHKOLLAVE DHE NGA VENDOSJA E LAPIDARIT TË LUFTËS NË BASHKINË E
BILISHTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga sistemim-asfaltimi i rrugës nga qendra e qytetit në drejtim të varrezave, sistemim-asfaltimi i rrugës ndërmjet dy shkollave dhe nga vendosja e lapidarit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në Bashkinë e Bilishtit.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Bilishtit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqet prej 1129,5 m², vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 1 129 500 (një milion e njëqind e njëzet e nëntë mijë e pesëqind) lekësh.

4. Fondi prej 1 129 500 (një milion e njëqind e njëzet e nëntë mijë e pesëqind) lekësh, për kompensimin e pronarëve të shpronësuar, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Bilishtit, për vitin 2003.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën prej 223 000 (dyqind e njëzet e tre mijë) lekësh, të përballohet nga Bashkia e Bilishtit, e cila do të kryejë edhe pagesën e pronarëve të shpronësuar.

6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë brenda periudhës 1-15 tetor 2003.

7. Punimet të përfundojnë brenda muajit nëntor të vitit 2003.

8. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe Bashkia e Bilishtit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

**Lista e pronarëve që do të shpronësohen si rezultat i sistemim-asfaltim rruge, qendër qyteti në
drejtim të varrezave, sistemim-asfaltim rruge midis dy shkollave, vendosje e lapidarit të luftës
ANÇ në Bashkinë Bilisht.**

Nr.	Emri Mbiemri	Sip.tokë (m ²)	Njësia (lek m ²)	Vlera (lekë)
1.	Trashëgimtarët e Refat Nallbatit Shadie Refat Nallbati Alije Osman Spaho Ylver Raif Noke Pranvera Raif Noke Fatmir Hysen Nallbati Zhuljeta Nallbati Mirela Skënder Nallbati Budjon Skënder Nallbati Firdes Hysen Nallbati Ritvan Hysen Nallbati Yllkë Fetri Nallbati	608 m ²	1000	608 000

	Rudi Feti Nallbati Pëllumb Feti Nallbati Viktori Nallbati Dritan Fejzi Nallbati Valent Fejzi Nallbati Monika Fejzi Nallbati Romeo Fejzi Nallbati Fredy Fejzi Nallbati Fiqiri Zenel Nallbati Nexhat Zenel Nallbati Refiko Zenel Nallbati			
2.	Trashëgimtarët e Rushan Ajçes Esma Ajçe Ismail Rushan Ajçe Niko Rushan Ajçe Përparim Rushan Ajçe	139.5	1000	139 500
3.	Ymer Ramadan Shurdho	37	1000	37 000
4.	Nexhip Xhevair Bregu	315	1000	315 000
5.	Trashëgimtarët e Neki Skotit Merjeme Skoti Luan Neki Skoti Ferdane Neki Skoti Silvana Neki Skoti	30	1000	30 000

Shuma :

1 129 500

VENDIM
Nr.661, datë 25.9.2003

**PËR KALIMIN E SHËRBIMIT UNIVERSITAR TË ORTOPEDI-TRAUMATOLOGJISË, NË
VARËSI TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 129 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të neneve 10 e 16 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimi universitar i ortopedi-traumatologjisë kalon në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë.

2. Ministrisë së Shëndetësisë në numrin e punonjësve, miratuar për vitin 2003, t’i shtohen 89 (tetëdhjet e nëntë) punonjës, numër i cili i zbritet Ministrisë së Mbrojtjes nga numri i punonjësve, i miratuar për vitin 2003.

3. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2003, t’i shtohet fondi prej 7 970 000 (shtatë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë) lekësh, për përballimin e pagave dhe të sigurimeve shoqërore për punonjësit e shërbimit universitar të ortopedi-traumatologjisë, fond, i cili i zbritet buxhetit të vitit 2003, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

4. Shpenzimet për mallra e shërbime të shërbimit universitar të ortopedo-traumatologjisë, deri në fund të këtij viti, të përballohen nga buxheti i vitit 2003, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

5. Shërbimi universitar i ortopedi-traumatologjisë, deri në sigurimin e mjediseve të përshtatshme, brenda vitit 2005, ta ushtrojë veprimtarinë e vet në mjediset dhe me pajisjet e Spitalit Ushtarak Qendror Universitar, sipas një marrëveshjeje të përbashkët ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

6. Për vitin 2004 e në vazhdim Ministria e Shëndetësisë të parashikojë në buxhet shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative, vetëm për medikamente dhe materiale mjekësore, ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve operative të vazhdojë të përballohet nga Ministria e Mbrojtjes, sipa pikës 5 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.9.2003.

7. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Civil <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2003	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2003	Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2003	Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2003

Doli nga shtypi më 9.10.2003

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë